

VENDIM
Nr.257, datë 11.4.2007

PËR KRITERET DHE PROCEDURËN E KOMPENSIMIT FIZIK ME TROJE
SHTETËRORE, TË SUBJEKTEVE TË SHPRONËSUARA, NË DISA RASTE TË VEÇANTA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12 e 29 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fondin e pasurive të paluajtshme, që do të përdoren për kompensim fizik të menjëhershëm, bëjnë pjesë sipërfaqe toke, pronë shtetërore, të cilat ndodhen brenda vijave kufizuese të qyteteve, që, për shkak të pozicionit dhe të sipërfaqes së vogël, nuk mund të shërbejnë për kompensimin e subjekteve të shpronësuar, në përgjithësi.

2. AKKP-ja të përdorë, për kompensim fizik të menjëhershëm, troje, të cilat në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme figurojnë në pronësi të shtetit dhe plotësojnë të paktën njërën nga kushtet e mëposhtme:

a) Trualli të ndodhet ndërmjet ose ngjitur pronave, të kthyer subjekteve të shpronësuar dhe kjo sipërfaqe të jetë jo më e madhe se 10 për qind e sipërfaqes së kthyer këtyre subjekteve.

b) Trualli të ndodhet ndërmjet dy ose më shumë pronave, ku ka shërbyer si rrugicë apo servitut, i cili, sipas vërtetimit të organit përkatës, e ka humbur funksionin, për të cilin ka ekzistuar.

c) Trualli të ndodhet në bashkim të dy ose më shumë pronave me sipërfaqe jo më të madhe se 10 për qind e sipërfaqes së tyre dhe të përfshihet në një ndërtim, publik ose privat, i cili, sipas vërtetimit të organeve përkatëse, nuk prek infrastrukturën apo urbanistikën në qytet.

3. Subjektet e shpronësuar, që të përfitojnë kompensim fizik të menjëhershëm, sipas këtij vendimi, duhet të paraqesin:

a) Kërkesën për kompensim fizik të menjëhershëm, pranë zyrës rajonale të AKKP-së, në qark.

b) Vendimin e AKKP-së ose të ish-Komisionit të Kthimit të Pronave, që u njeh të drejtën e kompensimit me truall.

c) Vërtetimin nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, se trualli është pronë shtetërore dhe plotëson kushtet e parashikuara në pikën 2 të këtij vendimi.

ç) Vërtetimin nga bashkia, se sipërfaqja e truallit, sipas studimit dhe/ose gjendjes faktike, e ka humbur rëndësinë dhe funksionin.

d) Vërtetimin nga organi përkatës, se ndërtimi, publik apo privat, në të cilin do të përfshihet trualli, sipas shkronjës “c” të pikës 2 të këtij vendimi, nuk prek infrastrukturën apo urbanistikën në qytet.

4. Zyra rajonale e AKKP-së në qark, brenda 10 ditëve nga paraqitja e kërkesës, pasi verifikon zbatimin e pikave 2 e 3 të këtij vendimi, i përcjell AKKP-së kërkesën e subjektit të shpronësuar, për kompensim fizik të menjëhershëm, si dhe dokumentacionin, e përmendur në pikën 3 të këtij vendimi.

5. AKKP-ja, pasi shqyrton kërkesën dhe vëren se kushtet, e përmendura në pikën 2 të këtij vendimi plotësohen dhe se dokumentet, e përcaktuara në pikën 3 të këtij vendimi, janë të vlefshme e të rregullta, ndjek, për realizimin e kësaj procedure, hapat e mëposhtëm:

a) Bën botimin në Fletoren Zyrtare të të dhënave të truallit, sipas kategorisë dhe vlerës së përcaktuar, duke lënë si afat të paraqitjes së kërkesave të mundshme deri në 30 ditë nga data e botimit.

b) Pranon të gjitha kërkesat e paraqitura për këtë truall dhe i shqyrton ato brenda afateve të parashikuara në nenin 17 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar.

c) Merr vendim për kompensim fizik të menjëhershëm, sipas këtij vendimi, duke respektuar radhën e preferencës, si më poshtë vijon:

i) Trualli i jepet, për kompensim fizik të menjëhershëm, subjektit të shpronësuar, të cilit i është njohur ky truall, por nuk i është kthyer, sepse, në kohën e daljes së vendimit përkatës, trualli vlerësohej i zënë.

ii) Trualli i jepet subjektit të shpronësuar, nëse plotëson kushtet e përcaktuara në shkronjën

“a” dhe/ose “b” të pikës 2 të këtij vendimi.

iii) Trualli u jepet subjekteve të tjera, të shpronësuar, nëse nuk ka aplikantë, sipas përparësive të përmendura më lart, dhe nëse plotësohet kushti, i përcaktuar në shkronjën “c” të pikës 2 të këtij vendimi.

6. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dërgon për regjistrim në zyrën rajonale përkatëse të regjistrimit të pasurive të paluajtshme vendimin për kompensim fizik të menjëhershëm.

7. Ngarkohet Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha